



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 07 – 24 shtator 2015.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Huamarrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia e zbatimit të projektit”, dhe KFW Frankfurt AM MAIN, “KFW”, për shumën 24 000 000.00 euro “Ujësjiellësi Rural III”.
3. Projektligji “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (MULTI BUOY MOORING)”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Anila Agalliu, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Silva Caka, Tom Doshi.

Të ftuar:

Benet Beci - Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Blendi Bushati - drejtor i Departamentit të Zhvillimit Rajonal në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Leonard Miloti - përgjegjës i Njesisë së Projekteve Hidroteknike në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Elona Mistrovica- përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Gentian Beqiri - drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Muharrem Cakaj - drejtor Juridik në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Rovena Beqiraj - drejtore e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Oltion Murataj – specialist në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Është mbledhja e parë e sesionit të ri parlamentar. Duke shpresuar që keni kaluar pushime të mbara, ju uroj një sesion sa më të suksesshëm.

Fillimisht kemi miratimin e kalendarit të komisionit për periudhën 7-24 shtator. Nuk ka ndonjë gjë të veçantë, thjesht pasqyron vendimmarrjen e djeshme të Konferencës së Kryetarëve.

Kemi një renditje të projektligjeve, por që jemi fleksibël nëse do të ketë ndonjë gjë që ka nevojë të ndryshojë.

Keni ndonjë gjë të veçantë?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam përshtypjen që dy materiale janë vendosur gabim këtu, sepse ne i kemi kaluar një herë, ku jam unë relator dhe zonja Hysi. Bëhet fjalë për ditën e mërkurë, datë 16.9.2015 “Për nëpunësin civil”, nismë e deputetit Shalsi, Ruli dhe Bitri. Këto dy nisma janë bashkë, është një ndryshim në ligjin “Për nëpunësin civil”, por edhe një ndryshim për pagat dhe shpërblimet. Për këto dy çështje ne kemi diskutuar gjatë, kemi marrë një vendim, kemi qenë të prerë në mendimin tonë si komision dhe e kemi realizuar një gjë e tillë. Mua nuk më duket normale që të rifuten përsëri.

Rifutja çfarë tregon? Që ne të zbutemi e të themi që po, do ta kalojmë këtë gjë.

Më duhet të them, zoti kryetar, duhet ta merrni ju, në fakt, nismën, më shumë si kryetar i Komisionit të Ligjeve, që edhe në ligjin e ardhur para një muaji e ca nga qeveria për nëpunësin civil, që kishte të bënte me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, ne kemi dhënë një propozim që drejtoritë e urbanistikave të bashkive të mos përfshiheshin te nëpunësi civil. Ky ishte një propozim që e kemi bërë si komision. Ndërkohë që ne në seancë plenare e kemi çuar propozimin tonë që jemi ne përgjegjës, por komisioni nga kanë ardhur nismëtarët e ka hedhur poshtë, ndërkohë që nuk ka të drejtë të hedh poshtë propozimin e një komisioni tjetër, madje e kanë kaluar në seancë plenare pa e ditur ne. Edhe kjo gjë nuk më duket normale dhe korrekte. Të dyja këto gjëra duhet të zgjidhen, por, në radhë të parë, kjo që është në kalendar, ku unë jam edhe relator. Mund të hapim procesverbalet e mbledhjeve, e kemi diskutuar dhe kemi thënë jo për këtë gjë, ndaj nuk e kuptoj pse rifutet përsëri në kalendar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Më mbetet të shikoj procesverbalet. Nëse kemi votuar, pa dyshim, nuk ka pse të qëndrojmë në rendin e ditës.

Ka tjetër gjë?

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me pikën 2 të ditës së sotme, nëse është e mundur, për të pasur më shumë kohë për ta konsultuar projektligjin, ta spostojmë në një ditë tjetër.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ka ndonjë gjë tjetër?

Në parim biem dakord me kalendarin? Dakord.

Para se të fillojmë, ka një projektvendim të sjellë nga administrata e Kuvendit, një kërkesë për të shtyrë afatin e paraqitjes së kandidaturave për Autoritetin për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, sipas zbatimit të ligjit, për shkak se ka qenë gusht dhe disa nga organizatat e shoqërisë civile nuk kanë pasur mundësi ta konsultojnë. Shtyhet për 15 ditë. Jemi të detyruar që ta plotësojmë këtë pikë. Jemi dakord? Dakord.

Fillojmë me rendin e ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Huamarrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe nga Fondi Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia e zbatimit të projektit”, dhe KFW Frankfurt AM MAIN, “KFW”, për shumën 24 milionë euro “Ujësjiellësi Rural III”.

Nga qeveria për të mbrojtur këtë projektligj është zoti Benet Beci, drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Faleminderit, zoti drejtor!

Nga Ministria e Financave Elona Mistrovica, nga Drejtoria e Borxhit. Faleminderit, zonja Elona!

Mund të fillojmë zoti Beci. Dëshirojmë të na bëni një paraqitje të shkurtër të projektit për shkak se ai u është shpërndarë me kohë deputetëve dhe ata janë njohur tashmë me të.

Benet Beci – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Është fjala për programin e ujësjiellësve ruralë III, që pason dy projekte të ujësjiellësve ruralë të përfunduar tashmë. Ky program është më i gjerë dhe përfshin gjithë Shqipërinë, ndërsa në dy programet e mëparshme kemi pilotuar ujësjiellësit ruralë I dhe II, kryesisht në veri.

Paketa e financimit të plotë të këtij projekti, përfshirë edhe komponentët, donatorët e tjerë dhe kontributin e qeverisë, është 40 milionë euro, por ne sot kalojmë 24 milionë euro që është pjesa e kredisë me KFW.

Qëllimi i projektit është furnizimi me ujë i popullatës në zonat rurale për 24 orë në ditë dhe për disa investime në kanalizime, që kryesisht do të mbulojë pjesën emergjente për kanalizimet në këto zona.

Siç e thashë, zona e ndërhyrjes është në të gjithë zonën rurale të Shqipërisë. Kemi eksperimentuar me sukses në dy fazat e para dhe mënyrën e përzgjedhjes dhe kushtet e kryerjes së këtyre investimeve, duke pasur parasysh që, në radhë të parë, të lëmë investime të vetëqëndrueshme, me kosto sa më të ulët, funksionale për popullsinë. Për këtë arsye kriteret që janë përcaktuar në përzgjedhjen e ujësjellësve, në radhë të parë, ne do të investojmë në zona në ujësjellës me gravitet, që nënkupton kosto të ulët të mirëmbajtjes dhe të shërbimit të ujësjellësve. Njëkohësisht edhe një kusht tjetër i rëndësishëm është bashkëfinancimi me njësitë e pushtetit vendor, duke bërë të mundur që ne të kemi një bashkëpunim, ku kontributi i pushtetit vendor është i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e ujësjellësve.

Koeficienti i koston për përfitues këtu luan rolin e maksimizimit të interesit me një kosto më të ulët, kemi një koeficient prej 350 euro për banor ose më poshtë.

Këto janë disa nga koeficientët dhe ka një sërë kriteresh, të cilat janë për t'u zbatuar përpara përzgjedhjes së investimit.

Do të kemi tri faza për realizimin e projektit: është faza e parë, përgatitja e fizibilitetit teknik, që nënkupton edhe përzgjedhjen e projekteve, do të kemi përgatitjen e dizajnit teknik, që është pjesë dhe paguhet nga paketa e projekteve, nënkuptohet që standardet e vendosura deri tani besoj do të jenë të tilla që të kemi projekte teknike sa më të sakta, është një nga kushtet për një investim të mirë dhe parashikojmë që zbatimi i projektit të zgjasë dy vjet.

Nga i gjithë projekti parashikohet që të përfitojnë rreth 75 mijë banorë në zonat rurale të të gjithë Shqipërisë nëpërmjet ndërtimit të 70 skemave ujësjellësish, ku një skemë kap një zonë ose një rajon.

Projekti është përshtatur dhe do të jetë në funksion të ndarjes së re administrative, ku partnerët tanë lokalë do të jenë njësitë e reja të bashkive të krijuara mbas reformës territoriale.

Është shumë e rëndësishme për ne dhe mendojmë se e kemi dhënë provën edhe në fazën e parë dhe të dytë të projektit që cilësia e lartë e standardeve evropiane e projekteve që financohen nga KFW dhe qeveria shqiptare së bashku të vazhdojnë të jenë në të njëjtin nivel. Po kështu ujësjellësit janë projektuar për një periudhë 30-vjeçare të funksionimit.

Veçoria e projektit është që ujësjellësit që do të ndërtohen nuk do të kenë nevojë të subvencionohen. Gjithë sistemi i ujësjellësit në momentin e përzgjedhjes nënkupton që ka masat e tij të menaxhimit, llogaritjet e pagesës së mbledhjes së të ardhurave në mënyrë që ujësjellësi i investuar të mos jetë një barrë për pushtetin vendor apo për ndërmarrjen, e cila e merr në dorëzim, por të jetë një ndihmë financiare për të. Ky është edhe gjithë qëllimi i projektit që qeveria shqiptare bën në bashkëpunim me bankën gjermane duke shfrytëzuar, në fakt, gjithë kapacitetet dhe eksperiencën e ndërtuar në këto vite në këtë fushë.

Ne, si agjenci implementuese, angazhohemi që të japim maksimumin dhe jam i sigurt që me eksperiencën që kemi me dy projektet e para, mund të ofrojmë investime shumë të vlefshme për zonat rurale.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti drejtor!

Ka pyetje?

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Si e keni planin, në cilat zona të vendit do të zhvillohen këto projekte? I mora vesh, zona rurale, po ku tamam?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Beci. Ju lutem, thoni territorin ose njësitë administrative ku do të zbatohen.

Benet Beci – Ky program nuk ka limit territorial, është për të gjithë Shqipërinë, ka sensin e një gare ku aplikon me kërkesa, pushteti vendos, argumenton për nevojat, bëhet fizibiliteti, vlerësohet dhe pastaj jepet lista e investimit. Në fakt, është një lloj procesi 6-mujori i parë do të jetë për përzgjedhjen e tyre, nuk ka kufizim gjeografik. Kush do të ketë nevojë më të lartë, koeficientët më të mirë të kostos për përfitues, për garancinë që është i qëndrueshëm, ai do të seleksionohet për t'u investuar. Është një proces seleksionimi, nuk ka kufizime gjeografike.

Fatmir Xhafaj –Faleminderit!

Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Jam në vijim të pyetjes së kolegut Ristani. Ju thatë ka një sens gare në këtë proces. Unë doja të dija kush i përcakton kriteret paraprake. A do të publikohen këto kriteret për këtë garë? Sa është e qartë për kompetitorët apo njësitë e ndryshme për të pasur akses pa u diskriminuar? Me çfarë procedurash e kryeni këtë proces konkurrimi, cila është baza ligjore?

Fatmir Xhafaj –Po, zoti Beci.

Benet Beci – Disa nga kriteret jua paraqita dhe kanë të bëjnë me koston për përfitues, me numrin e përfituesve, me rënien e lirë të projektit, me aftësinë për të bërë bashkëfinancim, me aftësinë për menaxhim, që është pjesë e vlerësimit. Pra, kushtet janë të përcaktuara në dokumentet zyrtare të KFW.

Ky proces nuk është i ri për ne. Në dy fazat e para ne kemi punuar me bashkitë, por vetëm në zonën veriore. E kemi bërë këtë konkurrim dhe vlerësim në bazë të të gjitha nevojave që vijnë.

Kushtet janë të përcaktuara qartë, janë të njohura, do t'u jepen edhe bashkive të reja, do të mblidhen kërkesat dhe do të zgjasë 6 muaj vetëm vlerësimi i fizibilitetit, i kërkesave dhe i kushteve. Janë të gjitha të njohura dhe transparente. Janë të gjitha në dokumentin ligjor.

(Zoti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Baza e kriterëve të përzgjedhjes është dhënë qartësisht në marrëveshje.

Fatmir Xhafaj –Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – E falënderoj drejtorin, por unë doja të bëja një pyetje në vazhdim të kolegëve të opozitës.

Fazën e parë që keni bërë në tri qarqet e veriut, Shkodër, Kukës dhe Dibër e keni bërë pa konkurrim? Këto 24 milionë që kërkonin që ne t'i ratifikojmë do t'i bëni me konkurrim në të gjithë Shqipërinë, kush do të konkurrojë në mënyrë më të mirë të mundshme për të marrë investime për ujësjellësin?

Ju prekët pak çështjen e ndarjes territoriale, por unë dua të pyes që këto 70 skema ujësjellësi që janë të reja, janë skema që do i shërbejnë tashmë një bashkie të plotë apo pjesë-pjesë, që nuk e dimë sa do të jemi në gjendje që të kemi. Pra, e kam idenë që më mirë të bëjmë investim ujësjellësi të një bashkie nga fillimi në fund e të kemi ujë 24 orë sesa të bëjmë skema ujësjellësi për 3-4 fshatra apo ish-komuna dhe e gjithë bashkia nuk furnizohet me ujë?

Pyetja e tretë është financiare. Ju thonin që ne sot duhet të kalojmë 24 mijë euro. Në fakt, financimi është 40 milionë euro, 16 milionë do t'i japë qeveria shqiptare. Në qoftë se do t'i japë qeveria shqiptare, ju jepni garanci, do të jenë të planifikuara këto në buxhetin e ardhshëm të shtetit, ku të jetë e plotë shuma e financimit të këtyre 70 skemave të ujësjellësit, pra të mos jetë thjesht financim për 24 milionë, pra 40 milionëshi duhet të jetë i kompletuar të paktën me buxhetin e vitit tjetër që ju të përdorni këto 70 skema ujësjellësi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Benet Beci – Është e vërtetë. Po e filloj nga e fundit. Paketa financiare është 40 milionë dhe është e kompozuar në këtë formë: 24 milionë euro që kalojnë sot janë kredi, 9,8 milionë euro janë grant nga komuniteti evropian që i bashkohet kësaj pakete, janë falas, ne e kemi kaluar edhe në komision. KFW vjen brenda paketës, ku, përveç kredisë, vjen me 1,5 milionë grant, që, në fakt, ia dedikon më shumë vetëqëndrueshmërisë dhe rritjes së kapaciteteve të menaxhimit të projekteve, dhe qeveria shqiptare hyn me 4 milionë euro si bashkëfinancim. Pra, 24 plus 9,8 plus 1,5 milionë plus 4 milionë bëjnë afërsisht 40 milionë euro që është gjithë paketa.

Për sa i përket pyetjes për qeverinë shqiptare, qeveria shqiptare e ka të përfshirë, edhe Ministria e Financave mund të garantojë për këtë, por në procedurë kjo përfshihet në buxhet, është krejtësisht e saktësuar dhe e sigurt që është pjesë e paketës dhe e marrëveshjes. Nuk shikoj asnjë risk në realizimin dhe përfshirjen e gjithë aktorëve në paketë.

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Mund të jetë diferencë e vogël, e kemi rrumbullakosur.

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Unë nuk ju ndërpreva që ju të bënit pyetje. Aritmetikë është kjo, besoj se 40...

(Zoti Fino flet pa mikrofon.)

Saktësoheni 40 milionëshin nga përbëhet.

Benet Beci – Është e përbërë nga 24 milionë euro kredi, 9,8 milionë euro është granti, 1,5 milionë euro granti tjetër, 4 milionë. Të gjitha bëjnë 39,3. Mungojnë 600 mijë, që është pjesa e një granti tjetër, të cilën nuk e përmenda duke qenë kaq e vogël. Është pra 670 mijë euro nga komuniteti evropian, që plotëson 40 milionëshin.

Për sa i përket konkurrimit, në dy fazat e para është ndjekur e njëjta procedurë dhe ka qenë jashtëzakonisht i vlerësuar procesi i seleksionimit në atë periudhë.

Për sa u përket bashkive të mëdha dhe organizimit të ri, projekti presupozon realizimin e 70 skemave të ujësjellësit dhe 75 mijë banorëve mbi bazën e procedurave që kemi. Sigurisht, rregullat janë që ne jemi të shpërndarë dhe do të përzgjedhim ujësjellësit në të gjithë Shqipërinë. Nuk kemi në plan që të fokusohemi vetëm në një bashki, pra të përfundojmë një bashki me të gjitha dhe të lëmë të tjerat. Është e vendosur marrëveshja në këtë rast, por, sigurisht, nëse investimi mund të maksimizohet për efekt të një bashkimi apo një skeme pak më komplete në një qytet më shumë apo më pak, kjo është një gjë që vlerësohet nga fizibiliteti dhe është objekt i vlerësimit teknik për të arritur kushtet e marrëveshjes.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti Beci, ju thatë që përzgjedhja do të bëhet në bazë të disa rregullave të përcaktuar në marrëveshje dhe në modelet e mëparshme, ndërkohë që në relacionin që shoqëron projektligjin ju thoni që projekti do të fokusohet në sistemet e ujësjellësve me rënie të lirë në fshatrat me numër më të lartë të popullsisë së qëndrueshme.

Keni ju një listë të zonave ose fshatrave ruralë që kanë rënie të lirë të ujit dhe që kanë numër të madh popullsisë dhe konkurrimi do të bëhet ndërmjet tyre? Shpjegimet tuaja sikur bien pak ndesh me këtë që sapo thatë.

Benet Beci – Ne për projektin nuk kemi një listë të dedikuar për këtë program. Kemi informacione të cilat ndryshojnë nga investimet e çdo viti. Çdo vit ka ndryshime, por kemi lista e informacione të cilat përditësohen në vazhdim. Pra, kemi informacion, por qëllimi i fazës së parë të projektit është saktësimi i të gjithë informacionit, rimarrja e të gjitha kërkesave dhe rivlerësimi i listës përfundimtare të nevojave dhe të ujësjellësve që plotësojnë kushtin e rënies së lirë. Praktikisht është pjesë e procesit dhe hartimi i informacionit paraprak mbi të cilin do të bëhet konkurrimi, pra, nuk është se sot kemi një listë të gatshme, por kemi informacione. Besoj se është e nevojshme të bëjmë një listë të kompletuar të përditësuar, pra të fundit.

Fatmir Xhafaj –Faleminderit!

Zoti Peza.

Dashamir Peza – Sa banorë parashikoni ju që do të përfitojnë nga këto investime?

Ju nga informacionet paraprake, me sa kuptova nga ato që thatë, sikur përmendët rreth 70 ujësjellës. Jam i saktë?

Benet Beci – Ne parashikojmë që minimumi i përfituesve të jetë 75 mijë banorë dhe një ose disa fshatra të përfshihen në një skemë.

(Zoti Beci flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Në fakt, sërish sot merren 24 milionë euro borxh, janë hua, të cilat janë para që do t'i paguajnë qytetarët shqiptarë dhe së bashku me fondet e tjera rreth 40 milionë, po të heq grantet, janë para të qytetarëve shqiptarë.

Unë do të mbështes çdo investim që do të bëhet për ujësjellësit, duke pasur parasysh edhe gjendjen jashtëzakonisht të rëndë që ishte me ujësjellësit gjatë verës së këtij viti, qytete, fshatra pa ujë, sidomos zonat turistike, duke e kthyer Shqipërinë nga një vend atraktiv, që ishte në fillim të vitit në të gjitha revistat prestigjioze, në një vend turpi për të gjithë turistët që

largoheshin nga Shqipëria, të cilët deklarorin të dëshpëruar në dogana për mungesë të theksuar të ujit të pijshëm, për mungesë të theksuar të ujit për t'u larë e për t'u pastruar. Sigurisht në të gjithë menaxhimin që do t'u besohet njësive të reja, në projektligj ne këtu, por edhe ju, duhet të kemi një vëmendje të veçantë në mënyrë që këto para, që janë të qytetarëve shqiptarë, që do t'i paguajnë qytetarët shqiptarë, të shkojnë në drejtim të investimeve publike, në drejtim të ujësjellësve, sepse, në qoftë se, po ju jap shembullin për dy njësi, paratë publike të qytetarëve shqiptarë, të buxhetit, në Durrës dhe në Kavajë nuk do të kishin shkuar për të ndërtuar shatërvanët qesharakë në qendër të qyteteve, të cilat ditën e inaugurimit u furnizuan me bote uji, qoftë Durrësi, qoftë Kavaja ndoshta do të kishin ujë. Pra, në qoftë se ato miliona euro që u investuan, që fare mirë ato njësi bashkiake që ju do ua jepni sërish tani, nuk do të ishin investuar për 1 mijë palma në Durrës dhe për 3-4 milionë euro që u bë qendra e Durrësit me shatërvanit, nëse ato njësi do t'i kishin investuar për ujësjellës, qyteti i Durrësit dhe zonat rurale nuk do të kishin vuajtur për ujë, si Shkëmbi i Kavajës, Golemi e me radhë.

Në qoftë se në Kavajë, ai kryetari i njësisë që është atje, nuk do t'i kishte harxhuar milionat e eurove për palma dhe për të ndërtuar shatërvanin, i cili, po e them, gjatë inaugurimit u mbush me bot vetëm e vetëm që të vinte Kryeministri para fushatës elektorale, atëherë ato para mund të kishin shkuar për të furnizuar Kavajën me ujë. Kavaja ka pasur gjatë gjithë kësaj kohe një orë ujë në dy ditë. Gjithë zona e plazhit, pjesa më e madhe është furnizuar me puse. Paratë e qytetarëve shqiptarë të buxhetit, që do t'i menaxhojnë sërish këta, shkuan për investime fasadë, për zgjedhjet po e po, ndaj duhet të jemi të kujdesshëm që të mos lejojmë më që kjo që ndodhi gjatë kësaj vere dhe gjatë këtij viti të ndodhë më. Paratë e qytetarëve shqiptarë duhet të destinohen për çështje jetike, siç është uji.

Në qoftë se paratë e qytetarëve shqiptarë i marrin e i përdorin për palma, paratë e ujësjellësit i përdorin për shatërvanë, që nuk funksionojnë, se vetëm gjatë inaugurimit, se Kavaja po e shikon që nuk funksionon, nuk del pikë ujë, sepse nuk kanë ujë në shtëpi, ky është paradoksi më i madh, madje pastaj fillojmë e bëjmë aksione për t'u rrjepur qytetarëve lëkurën dhe fillojmë aksionin e ujit.

Ndaj është shumë e rëndësishme që këto para që janë të destinuara, të paktën siç flitet këtu, për ujësjellës dhe që janë para të buxhetit dhe para të taksapaguesve shqiptarë, që do t'i paguajnë në vitet e ardhshme, duke rritur edhe më shumë nivelin e borxhit, duhet të shkojnë cent për cent në favor të ujësjellësve dhe jo për palma e shatërvanë siç kanë shkuar në Kavajë e në Durrës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino, keni fjalën. Jam i sigurt që e keni lexuar relacionin.

Bashkim Fino – Unë e kam lexuar relacionin, por nuk dua t'i kundërpërgjigjem kolegut tim, sepse ishte diskutim politik, të cilin mund ta bënte në seancë, nuk ka lidhje fare me projektligjin që është këtu.

Jo më kot e bëra pyetjen që faza e parë e këtij investimi në tri qarqet e veriut, Kukës, Dibër dhe Shkodër ka filluar në vitin 2008, kur ky që sapo foli ishte në pushtet. Ka filluar me këtë drejtor dhe po vazhdon faza e dytë po prapë me këtë drejtor, që do të thotë se këto fonde që marrim borxh nga KFW gjermane dhe nga qeveria shqiptare venë në interes të qytetarëve, duke bërë ujësjellës ose investime të tjera. Kjo është më se e qartë dhe e kuptueshme. Kjo nuk ka lidhje as me shatërvanë e as me palmat, sepse projektligji që ka ardhur këtu është konkret, është një projekt që kërkon 24 milionë që ne t'i ratifikojmë nga KFW gjermane për t'i hedhur në 70 sisteme ujësjellësish për të bërë investim. Në qoftë se kemi dyshime për ekzekutimin nesër në praktikë të saj, ne e kemi këtë të drejtë për të kontrolluar me plot të drejtë ekzekutivin se ku i ka hedhur këto lekë.

Dua të them që ky është një borxh i mirë në kuptimin e mirë të fjalës, sepse marrim, na ndihmon, dhe ne duhet të falënderojmë KFW që ka qenë gjithmonë një iniciatore që ka dhënë fonde për investimet në Shqipëri, sidomos për infrastrukturën, në mënyrë të veçantë për ujësjellësit. E falënderojmë edhe për këtë marrëveshje që ne kalojmë sot, sepse ne sot nuk po përqendrohemi vetëm në tri qarqet e veriut, por po përqendrohemi në të gjithë territorin e Shqipërisë, me konkurrimin e nevojshëm tani jo më të 384 njësive vendore që kanë qenë deri dje, por të 61 bashkive, po ka shumë mundësi që këto investime të jenë të përqendruara, të specializuara dhe do të kenë efekt më të mirë brenda 61 bashkive. Ndaj edhe unë e bëra pyetjen për të treguar që këto 70 sisteme ujësjellësish duhet të ishte mirë, pse jo, edhe një bashki e madhe, mund të marrë, një, pesë apo 10 sisteme ujësjellësish, për të zgjidhur problemin e ujësjellësit në territorin vet, sepse i takon kryetarit të ri të bashkisë të bëjë investime brenda territorit të madh të një bashkie shumë të madhe.

Mendoj se edhe filozofia e drejtorisë së zotit Beci duhet të ndryshojë tani në funksion të kësaj ndarjeje territoriale dhe gjithë investimet që ne i miratojmë këtu në parlament duhet të jenë në funksion të këtyre 61 bashkive me idenë për të bërë investime që të jenë në funksion të qytetarëve shqiptarë dhe aspak në atë mënyrë si foli parafolësi im.

Ajo që doja të thosha dhe që e kërkoj nga ju si kryetar i komisionit, e kërkoj këtë gjë edhe nga drejtori, në qoftë se do të japë ndonjë përgjigje, gjithë këto pyetje dhe shqetësime që ne kemi, në fund të fundit, pavarësisht se jemi deputetë të listave apo jemi deputetë të qarqeve të caktuara, nuk jemi deputetë maxhoritarë për të mbrojtur një bashki apo një zonë të caktuar,

mos do të ishte më mirë që fonde të tilla të ishin të listuara si investime përkatëse dhe të jetë arritur marrëveshja me donatorin përkatës kryesor përpara se të vijë në parlament se ku do të bëhet investimi dhe pastaj këtu vijmë e ratifikojmë marrëveshjen, ku të jenë të konkretizuar që ky fond i KFW gjermane do të jenë për këta 5 ujësjellës në 61 bashki, 1, 2, 3, 4, 5. Të jesh i bindur, zoti drejtor, që nesër, nëse do të bëhet një marrëveshje e tillë dhe do të arrihet të bëhet një listë e saktë e investimeve përpara se të miratohet në parlament, pastaj legjislativi ka të drejtë të kontrollojë ekzekutivin si e ekzekuton këtë që ne miratuam, atëherë nuk do të ketë as pyetje, as diskutime në sensin praktik. Me të drejtë kolegëve u lind dyshimi dhe pyesin se ku do të shkojnë këto para apo 70 skema ujësjellësish, ndërkohë që ne e miratojmë fondin, bëhet efektiv qoftë edhe nga qeveria shqiptare dhe pastaj menaxhimi i saj do të bëhet nga strukturat ekzekutive që jeni ju së bashku me pushtetin vendor. Kjo do të ishte gjëja më transparente dhe më e mirë që mund të kishin deputetët këtu, megjithëse janë deputetë të popullit dhe i ka votuar populli, për të votuar për ato investime që duhet të venë në interes të popullit. Jam shumë i bindur që investimet që drejtoni ju dhe që i keni marrë qoftë në kohën e Partisë Demokratike, qoftë edhe në kohën tonë kanë pasur efekt dhe kanë shkuar në interes të qytetarëve shqiptarë, qoftë për rrugë rurale, qoftë për ujësjellës qoftë edhe për investim tjetër. Uroj të vazhdojnë kështu vetëm me këtë sugjerim që bëra unë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zoti Bylykbashi, pastaj zoti Peza.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar,

Marrëveshja sigurisht që ka rëndësi, sepse janë para, të cilat do të merren hua, por qartazi do të shkojnë për një interes jetik të popullatës, siç është furnizimi me ujë. Kolegu Halimi përmendi me të drejtë situata shumë akute gjatë kësaj vere në lidhje me furnizimin me ujë dhe në mënyrë të veçantë në zona turistike, në zonën e Durrësit, Kavajës, por edhe në jug të Shqipërisë, të cilat kanë përjetuar një situatë që vërtet e ka ulur pritshmërinë që ne kishim qëllim në lidhje me sezonin turistik, në lidhje me figurën që duhet të bëjë Shqipëria në raport me tregun ndërkombëtar turistik.

Ka të drejtë zoti Fino, është kredi e mirë, sepse shfrytëzohet për investim, unë vlerësoj edhe punën që keni bërë, ajo është e ngjashme me punën që është bërë në kohën tonë.

Nuk është si ato kreditë që janë marrë thjesht për konsum apo për të mbyllur gropat e buxhetit, siç janë marrë deri më sot qindra miliona euro – por s’dua të ndalem as këtu.

Pyetjet që bëra ishin në lidhje me një shqetësim specifik. Pra, që ne duhet të garantojmë transparencë dhe miradministrim të këtyre fondeve, në mënyrë që ato të

shpërndahen te popullata pa asnjë diskriminim të çfarëdo lloji. Nuk ka rëndësi fare, domethënë. E rëndësishme është që nga këto para të përfitohet sa më shumë e sa më gjerë në territor.

U tha këtu, ne jemi deputetë të popullit; sigurisht, ne kemi edhe interesa për zona të caktuara, diku më shumë, diku më pak, dhe është shumë e rëndësishme që procedurat përzgjedhëse të jenë të tilla, që të çojnë paratë aty ku është nevoja.

Unë kam shpresë që edhe mbikëqyrja që ushtron në rastin konkret KfV-ja, do të garantojë se nuk do të ketë abuzime.

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Fino, a mund të vazhdoj unë?

Një problem i madh që duhet të shmanget nga procedura transparente, korrekte, e përzgjedhjes, jo vetëm të përfituesve, por edhe të atyre që më vonë do të zbatojnë këto projekte, është për të eliminuar maksimalisht fenomene korruptive që vijnë për shkak të presionit që strukturat e ekzekutivit do të ndikojnë mbi drejtorinë, për t'i çuar paratë në territor jo vetëm në mënyrë klienteliste, por në mënyrë klienteliste të klientët e qeverisë. Sot nuk ka më asnjë dyshim që korrupsioni politik, galopant në Shqipëri, po financohet në mënyrë skandaloze nga tenderët. Jo më larg se pak ditë më parë, ne kemi denoncuar një rast, kur një kompani, e cila ishte afër fondit limit fitonte një tender, duke u anuluar të gjitha ofertat e tjera. Kjo vetëm e vetëm se kandidati i maxhorancës ishte edhe pronar i kompanisë. Kjo ndodhte përpara procesit zgjedhor.

Pra, për ta mbyllur këtë, unë shpresoj se drejtoria, KfV-ja do të ushtrojë një mbikëqyrje shumë të fortë, në mënyrë që paratë të shkojnë tek ata që kanë vërtetë hall, dhe projektet të fitohen nga ato kompani që japin vlerën më të mirë për paranë që shpenzohet, e jo tek ata që e kanë ndarë llokmën e parave për ministrin përkatës apo për forcën politike që më pas do t'i përdorë për interesa korruptive apo politike.

Fatmir Xhafaj – Zoti Peza!

Dashamir Peza – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë bie dakord për një gjë dhe vërej diçka shumë pozitive: në përgjithësi, të gjithë diskutantët flasin lidhur me eficiencën e këtyre investimeve; nuk është se nuk janë dakord për mënyrën e investimeve.

Edhe unë, në frymën e këtyre diskutimeve, kam nja dy shqetësime të vogla, ose nja dy preokupime, që ndoshta me kohë do të më davariten.

Në një farë mënyre, më bën përshtypje se ky është vazhdimi, po themi, i dy iniciativave të mëparshme. Kjo është e treta në kuptimin e investimeve, dhe në këtë radhë do

të investojmë 40 milionë euro. 40 milionë euro për 75 mijë banorë. Nuk e di sa eficientë janë do milionë euro për 75 mijë banorë. Ne do të bëjmë 70 projekte, kur kemi 61 bashki.

Dëgjuam këtu fjalën “e qëndrueshme”, dëgjuam fjalët “investime të qëndrueshme”, por nuk i dëgjova asnjëherë fjalët “projekte integruese”. Kjo në kuptimin se ne do të bëjmë një çikë më shumë se një ujësjellës për bashki? Do të investojmë miliona euro vetëm për faktin se është me vetërrjedhje, ka kosto më të lirë, dhe kjo quhet efiçiente?

Për analogji, do të më lejoni t’ju them – ndoshta shifrat nuk më kujtohen shumë mirë – se investimi i Bovillës, gjë që Bashkimi duhet ta dijë më mirë, nuk e kalon shifrën e 100 milionë eurove; për atë kohë, se aktualisht mund të kushtojë shumë më shumë. Me 100 milionë euro prodhohen 800-1200 litra ujë në sekondë, dhe normalisht duhet t’i shërbejë gjithë Tiranës. Vjena, me sa di unë, me informacionin që kam, shërbehet me 800 litra ujë në sekondë.

Në këtë sens, a mos vallë duhet të heqim dorë nga kjo mënyrë. E kanë parë në dy herët e mëparshme kolegët tanë kur kanë qenë në pushtet, se thjesht investojmë mbi projekte bashkish ose fshatrash të veçuar, apo duhet parë ky koncept i shpenzimit të këtyre 40 milionë eurove në një mënyrë më efikase, që të shërbejnë më mirë.

Në kohën kur ne ishim në opozitë, mua më ka pas pëlqyer përmendja e projekteve të integruara, projekte që ndoshta nuk duhet t’i shohim as në bashki, por duhet t’i shikojmë në rajone. Ndoshta do të jemi më eficientë duke i parë. Vërtetë mund të ketë kosto më të mëdha në kuptimin e shtrimit të rrjetit të shpërndarjes së ujit, por unë e shikoj si më efikase: studimi i efiçencës së ndërtimit të ujësjellësve, të cilët janë më të përqendruar se sa ky koncepti i ndërtimit nga një ujësjellës në çdo fshat.

Ndoshta këtu e bëjmë diferencën me çështjen e opozitës. Më bëri përshtypje fakti se u përmend këtu edhe nga zoti Bylykbashi shqetësimi për mungesën e furnizimit me ujë në zonat turistike. Dua t’i kujtoj zotit Bylykbashi se çështja e furnizimit me ujë të zonave turistike, në deklaratat e bëra në Parlamentin e Shqipërisë, ka mbaruar që në mandatin e parë të Berishës, kur premtoi se do të ketë 24 orë ujë.

(Diskutim pa mikrofon)

24 orë ujë. Kjo është çështje që ka mbaruar.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, ua morëm ne. E piu kuçedra.

(Diskutim pa mikrofon)

Pa tjetër: ju e lëshuat ujin, ne e pimë.

Zoti Bylykbashi, nga eksperiencat e hidhura është mirë të mësojmë të gjithë.

Kur foli Halimi këtu, përmendi shqetësimin për rrezikun nëse do të ketë ujë shatërvani i Kavajës. Dhe ai e ka eksperiencën nga shatërvani mi Zogut të Zi, kupton? Aty e ka marrë eksperiencën ai. Ka gjashtë vjet që e shohim të thatë. Ka të drejtë, dhe nuk kama asnjë lloj shqetësimi për faktin që e ngre këtë problem. Në qoftë se kanë bërë shtërvanin, inshallah kanë mundësi edhe ta mbajnë me ujë, e të mos e lënë si shatërvanin e Lulit, që u tha si në shkretëtirë.

Pa diskutim ne duhet të luftojmë, duhet të përpiqemi të mësojmë nga gabimet kemi bërë, sepse nuk është puna e luftës politike që bëjmë me njëri-tjetrin, por problemi është: çfarë bëjmë më mirë? Si përmirësohemi ne? Si i bëjmë gjërat?

E për këtë unë kam dyshime. Kam dyshime se ajo që keni bërë ju – jo pse e keni bërë ju – a është efiçiente? A është efiçiente ajo mënyrë logjike dhe ajo lloj procedure që keni zgjedhur ju, që shkoni e investoni në fshatra të veçuara? Personalisht ngre dyshime.

S duhet neve të investojmë para për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe për të përmirësuar infrastrukturën? Pa diskutim që duhet ta bëjmë. A duhet neve të luftojmë korrupsionin? Për mua, më mirë luftohet korrupsioni kur janë tre, katër, pesër projekte të mira, të shëndosha, të qarta, të cilat investohen, se sa kur shpërndahen në shtatëdhjetë projekte, që në fund nuk jemi në gjendje t'i kontrollojmë.

Vërtetë KfV-ja ka dhënë mbështetje të ngjashme me këtë, por unë jam kureshtar të di se sa litra ujë vijnë nga këto projekte. Sa orë furnizim me ujë vijnë nga këto projekte? Kjo është çështje e rëndësishme. Nuk është problemi se çfarë do të investojmë, por problemi është: sa të qëndrueshme dhe sa të integruara janë si projekte? Ky duhet të jetë koncepti dhe fryma me të cilën neve duhet ta zhvillojmë konceptin.

Përfundimisht, ju them se unë e mbështes këtë nismë. Uroj që gjatë rrugës, meqenëse ka edhe gjashtë muaj kohë, drejtuesit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, qeveria vetë, por edhe partnerët tanë që financojnë në këtë, të gjejnë rrugët më të mira, që këto projekte të jenë më të qëndrueshme, por të jenë edhe të integruara.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Peza!

Zoti Manja, kishit diçka? Në rregull.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Pas këtij diskutimi të kolegut Peza, mua s'më ngelen shumë gjëra për të thënë, por vetëm dua t'i bashkangjitem me dy mendime. Këto projekte janë të mirëpritura dhe, si duket, gjermanët e austriakët, që janë ndër donatorët më të mëdhenj në financimin e projekteve në ujësjellës në këto vitet e fundit, kanë njohuri të thella për Shqipërinë, sepse, qëkurse e kanë vënë theksin te sistemet e ujësjellësve me rënie të lirë, ata e dinë se Shqipëria është një vend i

begatë, që ka kaq shumë burime natyrore me rrjedhje të lirë, sa neve, kësaj gjeneratës që jemi tani në politikë dhe në ekzekutiv, nuk na ka ngelur gjë tjetër, por thjesht të rikthejmë atë sistem ujësjellësish që ne e kishim deri në vitin 1992. Sepse shqiptarët kanë pirë ujë, kanë pasur ujë të rrjedhshëm, e madje dhjetëfish më shumë nga ç'ka sot, por në vazhden e shumë shkatërrimeve që bëri politika në këtë vend, gjë që fillon në vitin 1992, kohë kur u kapën kazmat dhe u shkatërrua gjithçka e mirë që ish ndërtuar në këtë vend, me ujësjellës, me ujë të pijshëm, me sisteme vaditëse, me sisteme kulluese, me frutikulturë, me një bujqësi ndoshtandoshta e krahasueshme me tre-katër vendet më të zhvilluara të Europës, por kjo gjenerata që qeverisi Shqipërinë pas vitit 1992, e që na çoi edhe në luftë civile në 1997-ën, tani vjen dhe shqetësohet – me të drejtë, kolegu Peza – për shatërvanin e Durrësit e të Kavajës.

Si duket, tani në 2013-ën, me gjithë të metat që ka kjo qeverisje që ka ardhur...

(Diskutim pa mikrofon)

Nuk jemi perfektë. Perfekt është vetëm Zoti. Po të mos kishim qenë me atë shkallë përgjegjshmërie që kishim, ujësjellësi i Kavajës, ai ujësjellësi i famshëm i Manskurisë, në mos gabo, nëse nuk do të ishte konstatuar në kohë diga e atij ujësjellësi, jo vetëm që nuk do të kishte plazh atje në Kavajë e në Golem, por do të kishim katastrofa në njerëz.

Tani thirrja ime është shumë miqësore: le të bëjmë politikë me gjithçka, por vetëm me ujin e pijshëm jo, sepse është fatkeqësi që, me gjithë këto burime me rrjedhje të lirë, ne sot jemi prapë pa ujë. Dhe a e dini pse jemi pa ujë? Pikërisht sepse e kemi bërë edhe ujin objekt të politikës.

(Diskutim pa mikrofon)

Unë do ta votoj jo vetëm në parim, por edhe nen për nen. Më vjen mirë që një nga kriteret e vendosura nga donatorët, është sistemi i ujësjellësve me rënie të lirë.

Unë jam i bindur se është edhe mundësia projekteve të integruara, siç tha edhe kolegu Peza, sepse burimi mund të jetë në territorin e një bashkie, ndërsa mundësia apo gjurma ku kalon rrjeti i ujësjellësit mund të qarkojë dy ose tre bashki. Në këtë kuptim, unë do t'i kërkoja dhe do t'i sugjeroja fondit, që të shihet mundësia e projekteve integruese dhe konkurruese në këtë fokus. Sepse, fjala bie, burimi i ujit është në Kala të Dodës, por në këtë burim që do të jetë burimi kryesor i ujit, mund të qarkohen shtatë, tetë apo dhjetë njësi administrative brenda së njëjtës bashki, por e njëjta situatë mund të jetë edhe në bashki të ndryshme.

Kështu që unë, duke dhënë votën time pro kësaj marrëveshjeve, u sugjeroj kolegëve që ta lëmë ujin larg politikës, sepse kemi ca çështje më të rëndësishme, besoj unë, për t'u marrë me politikë, siç është edhe çështja e reformës në drejtësi, si dhe shumë gjëra të tjera, të cilat janë objekt i këtij sezoni parlamentar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Ristani. Diskutim.

Arben Ristani – Absolutisht dakord me marrëveshjen. Shumë mirë. projekte të tilla duhen, sepse u shërbejnë qytetarëve, por ajo që kolegu Halimi nënvizoi kishte të bënte me faktin që, duke qenë se këto para merren borxh, dhe duke qenë se ky borxh u ngarkohet po shqiptarëve, të cilët do ta paguajnë, i gjithë problemi vjen të mirëadministrimi i buxheteve. Sepse, tha kolegu, në qoftë se buxhetet do të ishin miradministruar dhe nuk do të përdroreshin thjesht për shatërvanë jofunksionale apo për palma, mund ta kishim marrë borxhin një çikë më të vogël. Besoj se shqetësimi është fare fare qytetar, fare fare normal.

Mund të vinim ca palma më pak, të shtonim ca lekë më shumë te ujësjellësit e të merrnim ca borxh më pak. Kjo është një vërejtje tërësisht normale, qytetare. S’ka nevojë për t’u ekzaltuar kaq shumë.

E dyta që theksoi kolegu, e që dua ta theksoj edhe unë: sigurisht, të gjithë e dimë se jetojmë në një vend ku ka korrupsion. Duhet të gjejmë mënyra dhe të marrim masa të atilla, që korrupsioni të mos na i hajë edhe këto lekë që i marrim borxh, sepse, sigurisht, barra mbi qytetarët shtohet dyfish, trefish e me tepër. Shqetësimi është fare normal.

Unë nuk besoj se ndokush nga ne mund të thotë sot se ne s’kemi sot, se jemi të imunizuar nga korrupsioni dhe këto lekë shkojnë tamam atje ku duhet, kështu që shqetësimi ishte tërësisht normal. Por të nisesh nga këto dy shqetësime normale dhe të fillosh të evokosh kohën e Enver Hoxhës, kjo është kujë e zezë. Ju del tamam nga shpirti. Domethënë, zotëria fillon e thotë s enë kohën e Enver Hoxhës ishim mirë, bujqësia ishte e zhvilluar, me ujësjellës, kanalizime. Domethënë, të vish sot i ri – sepse bashkë jemi gati në një moshë – dhe të fillosh të thuash: “O zot, sa mirë ishim në kohë të Enver Hoxhës dhe e prishi demokracia”, kjo ju del tamam nga shpirti dhe ju tregon fytyrën e vërtetë...

(Diskutim pa mikrofon)

Po lëre, mos u merr tani!

(Diskutim pa mikrofon)

Dakord! Dakord!

Po lëre, se kjo që po thua ti është pa lidhje.

(Diskutim pa mikrofon)

Është pa lidhje.

Po dëgjo, dëgjo, ti e evokove, jo unë.

(Diskutim pa mikrofon)

Ti e evokove, po prit tani!

(Diskutim pa mikrofon)

Ju del nga shpirti.

(Diskutim pa mikrofon)

Ju jeni edhe shpifarakë. Edhe shpifni. Edhe shpifni, përveç të tjerave.

(Diskutim pa mikrofon)

Ajo që po të them është kjo: të doli instinktivisht ndoshta...

(Diskutim pa mikrofon)

Derisa të del prapë, po ta them edhe unë prapë.

(Diskutim pa mikrofon)

Prandaj po ta them prapë.

Atëherë më dëgjo, prandaj po ta theksoj prapë, se bëni një gabim shumë të madh që doni...

(Diskutim pa mikrofon)

Shiko, mos u merr personalisht, sepse bën një gabim shumë të madh.

Fatmir Xhafaj – E mbyllim këtu.

Arben Ristani – Bën një gabim shumë të madh. Po ta them edhe një herë, sepse nuk mund të kthehemi në atë kohë, nuk mund të evokojmë atë kohë, nuk është kjo politika që i duhet këtij vendi.

Fatmir Xhafaj – Dakord, dakord!

Arben Ristani – Dhe bëni shumë gabim që ktheheni në këto përmasa. Kjo është tamam fytyra që tregoni. Dhe pastër fare.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit, zoti Ristani!

Zoti Drejtor, krijova përshtypjen, përtej tensioneve politike...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, a ka mundësi? Kur ju ndërhyjnë juve...

(Diskutime pa mikrofon)

Mirë pra, edhe me zotin Fino, qëparë.

Unë po i kërkoj drejtorit, i cili jashtë këtyre tensioneve politike, jashtë këndvështrimeve politike, jashtë përfitimeve të interesave politike apo nevojës për të bërë karrierë në politikë, dëshiron të japë dy-tre komente për projektin që ka sjellë këtu.

Zoti drejtor, ju lutem!

Benet Beci – Po, unë e ndjej të nevojshme të bëj dy-tre komente, duke vlerësuar shqetësimet e hedhura shumë seriozisht në këtë tavolinë. Në fakt, kemi shumë vite që po punojmë për të krijuar standarde, po punojmë fort me donatorët, dhe në qoftë se këto vite kemi një prurje, do të thosha të konfirmuar, është krijimi i standardeve dhe i sistemit të punës, që nënkupton përzgjedhjen dhe përgjegjshmërinë e investimeve maksimale.

Dua t'i siguroj të gjithë deputetët që, siç kanë parë në shumë projekte të bëra në gjithë këto vite – kemi gati 15 vjet që punojmë në sektorin e investimeve – se standardet e krijuara së bashku me donatorët, që në këtë rast janë me gjermanët, Bankën Botërore, janë në fakt standardet cilat si princip kryesor kanë mirëmenaxhimin e fondeve, përzgjedhjen e mirë të projekteve dhe maksimizimin e përfitimit.

Këtë e kemi dëshmuar në dy fazat e para të projektit dhe jam i sigurt se do ta dëshmojmë edhe në fazën e tretë të projektit, kështu që e ndjeva të nevojshme t'ju rikonfirmoj se projekti punon mbi bazën e marrëveshjes me donatorët, mbi bazën e eksperiencës shumë të mirë që kemi krijuar me KfV-në dhe mbi bazën e standardeve e sistemit të krijuar në menaxhimin e fondeve, që sigurojnë një investim të mirë për popullatën.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nuk besoj se ka gjë tjetër. Unë i bashkohem personalisht komenteve që u bënë këtu dhe vlerësimeve që dha edhe përfaqësuesi i qeverisë. Besoj se ndajmë të njëjtin vlerësim se projekte të tilla janë të mirëpritura. Janë të mirëpritura edhe sepse kanë dëshmuar se janë në interes të zhvillimit ekonomik dhe të interesave sociale të vendit. Për më tepër edhe vetë Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka treguar se ka menaxhuar me sukses një sërë projektesh në kompetencën e tij, por nga ana tjetër duhet të vlerësojmë edhe faktin se KfV-ja ka demonstruar se ka investuar dhe ka zbatuar projekte shumë të suksesshme në Shqipëri.

Unë po ju bëj dy qasje. Një qasje është rasti – më duket se përmendi zoti Fino; nuk e mbaj mend – Korçë-Pogradec, ujësjellësi që ka ndërtuar KfV-ja, në kuptimin jo thjesht me fondet por edhe me asistencën e KfV-së, dhe ujësjellësi i Vlorës, që – janë dy pamje krejt të ndryshme – në projektet e mëparshme kanë krijuar dy modele dhe dy standarde të ndryshme.

Kështu që, përpara se të mundohemi të bëjmë politikë me shatërvanët, le të bëjmë politikë mbi interesat e qytetarëve dhe në interes të qytetarëve.

Ajo që e bashkon këtë – dhe s'do të duhej të kishte shumë fjalë sot – është fakti se ky financim është një financim për një projekt të rëndësishëm, për një projekt që i shërben një interesi thelbësor të qytetarëve, siç është nevoja për të pasur ujë të pijshëm, dhe këtu mbaron çdo diskutim.

Pa dyshim janë të mirëpritura të gjitha diskutimet që kanë të bëjnë me eficiencën, me nevojën për të qenë më racionalë, me nevojën për t'i përdorur më mirë këto, por ajo që na bashkon të gjithëve, besoj se është kjo gjë.

Duke mirëkuptuar edhe vapën e madhe të gushtit, e që po vazhdon për fat të keq edhe në shtator, mund të hyjmë edhe te pjesa e votimit.

Kush është dakord në parim? Kundër? S'ka.

Miratohet në parim.

Neni 1. Dakord?

Dakord.

Neni 2. Dakord?

Po?

Elona Mistrovica – Në nenin 1 të projektligjit, ajo shifra...

Fatmir Xhafaj – Po, e pashë në relacion.

Elona Mistrovica – Duhet hequr ato dy zerot në fund.

Fatmir Xhafaj – Dakord edhe me sugjerimin e relatores. Ishte në relacion, prandaj nuk e përmenda, për te ekonomizuar kohën, por nuk e dija se kohën e kishim me tepriçë, në fakt, për të bërë politikë.

Dakord me këto.

(Diskutim pa mikrofon)

Mirë, pra, dakord, me politikë që s'ka lidhje me këtë gjë. Politikë shatërvanësh tani.

(Diskutim pa mikrofon)

Po mirë, pikëpamjen time thashë unë.

(Diskutim pa mikrofon)

Po unë thashë pikëpamjen time, nuk thashë tënden.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, dakord!

Në tërësi, kush është dakord? Kundër? Abstenime s'ka.

Miratohet!

Faleminderit!

Faleminderit përfaqësuesve të qeverisë! Faleminderit zotit drejtor!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.09.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (MULTI BUOY MOORING)”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Anila Agalliu, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Silva Caka, Tom Doshi.

Të ftuar:

Benet Beci - Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Blendi Bushati - drejtor i Departamentit të Zhvillimit Rajonal në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Leonard Miloti - përgjegjës i Njesisë së Projekteve Hidroteknike në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Elona Mistrovica- përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Gentian Beqiri - drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Muharrem Cakaj - drejtor Juridik në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Rovena Beqiraj - drejtore e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Oltion Murataj – specialist në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Fatmir Xhafaj - Pika e tretë e rendit të ditës është projektligji “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës BOT, ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit e Infrastrukturës, dhe shoqërisë koncesionare Porti MBM”.

Siç e patë – ndoshta ishit që në fillim të pranishëm këtu – kolegu Bylykbashi ka kërkuar një shqyrtim të mëvonshëm të procesit, por gjithsesi, edhe ne biem dakord me këtë gjë, për t’i dhënë kohën dhe mundësinë për t’u njohur më mirë me projektin dhe për ta konsultuar, gjë që është normale.

Sot po bëjmë një paraqitje në parim të projektit. Njëri prej jush do të bëjë paraqitjen në parim. Nesër ose javën e ardhshme do të vazhdojmë diskutimin në parim, pyetje, diskutime dhe shqyrtimin nën për nën të projektit.

Kush do ta paraqesë në parim?

Po, prezantohuni!

Gentian Beqiri – Më quajnë Gentian Beqiri dhe jam drejtori i financave të Drejtorisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Fatmir Xhafaj – Po.

Gentian Beqiri – Si propozim, ky koncesion erdhi në formën e një propozimi të pakërkuar të subjektit Adriatic Petroleum, i cili pasi kishte bërë një shqyrtim të tregut vendës, duke parë se aktualisht, në tregun vendës, mundësia e hyrjes së anijeve cisternë është deri në 20 mijë ton, dhe mbi 20 mijë ton ngelet një fashë e cila nuk është e plotësuar, kërkoi që të kishte mundësinë të operonte dhe të sillte anije me kapacitet mbi 20 mijë ton, duke pasur parasysh se edhe thellësia e kërkuar për hyrjen e këtyre anijeve është nga 18 deri në 20 metra. Edhe mbi 8 metra mund të hyjnë anije që – varet nga ana teknike – e kanë fundin e sheshtë.

Sipas një studimi paraprak të kërkesës së kompanisë, që pastaj u plotësua me studimin e vizibilitetit, kryer nga grupi i punës, u vlerësua që do të arrihej të sillej në Shqipëri afërsisht deri në 1 milion ton, prej të cilave 40% do të mbulonin edhe tregun e Ballkanit, duke pasur parasysh edhe kërkesën për karburant. Ndërkohë, një nga avantazhet e këtij koncesioni është se ndodhet në një zonë industriale, siç është Porto Romano, që është miratuar me vendim qeverie. Gjithashtu do të ndikojë në një të ardhme, domethënë në momentin e fillimit të operimit të punës do të ndikojë edhe në uljen e çmimit, të paktën në uljen e çmimit të karburanteve, si dhe në rritjen e të ardhurave të shtetit.

Nga ana e buxhetit të shtetit, domethënë, vetë qeveria shqiptare nuk ka asnjë detyrim, pasi të gjitha investimet janë për llogari të koncesionarit, të gjitha detyrimet, taksat dhe investimet. Gjithashtu, koncesionari do të investojë një vlerë prej rreth 10.2 milionë dollarë,

si vlerë fillestare, dhe në pesë vitet e fundit do të ketë një vlerë prej rreth 40% të vlerës së investimit, e cila do të kalojë në riinvestim. Pra, në momentin që do t'i kthehet shtetit përsëri mbrapsht, ai do të ketë kryer edhe rreth 40% të kësaj vlere. Edhe fee – ja koncesionare është në nivelin 2%, e cila do t'i paguhet shtetit.

Fatmir Xhafaj – Kaq kishit?

Në rregull. Mirë.

Besoj se nesër mund të jetë përsëri në rend dite dhe do t'ju njoftojmë. Gjithsesi, e mbyllim këtu këtë paraqitje.

Nesër përgatituni për përgjigjet e pyetjeve, diskutimet dhe komentet e tjera. Do t'ju kërkoja që mbasi të merrni njoftimin sot nga ana jonë.

E mbyllim këtu këtë mbledhje.

Faleminderit!

Gjithë të mirat.

MBLEDHJA MBYLLET